



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektori@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor

Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 2/111  
Datë: 2/9/2016


Senati i Universitetit të Prishtinës “ Hasan Prishtina” në mbledhjen e mbajtur me datë 02.9.2016 mori këtë

V E N D I M

Për plotësim ndryshim të nenit 7, pikës 1 të paragrafit 4 të Rregullores për studimet e doktoratës nr. 1/775 të datës 9.9.2014.

Ndryshimet e Rregullores të sipershënuar janë si në vijim:

- I. Pika 1 e paragrafit 4 të nenit 7 të Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:
  1. Nota mesatare gjatë studimeve themelore/bachelor dhe Master ka një vlerë maksimale prej 40 pikëve (që shpërndahet përpjestimi: 20 pikë maksimale për notën mesatare në studime themelore dhe 20 pikë maksimale për notën mesatare në studime Master), të cilat pikë llogariten në mënyrën e përcaktuar si në pikën a), b), c) dhe d) të këtij paragragji:  
Kriteret e përcaktimit të përparësisë në radhitje përzgjedhëse janë:
    - a) Nota mesatare gjatë studimeve themelore/bachelor është e barabartë me numrin e pikëve (p.sh.: nota mesatare 8.49 e barabartë me 8.49 pikë);
    - b) Nota mesatare gjatë studimeve master ose ekuivalente me master është e barabartë me numrin e pikëve (p.sh.: nota mesatare 8.49 e barabartë me 8.49 pikë);
    - c) Nota mesatare për studimet e përcaktuara si në pikën a) dhe b) të këtij paragragji, shumëzohet me dy (p.sh.: nota mesatare  $8.49 \times 2$  e barabartë me 16.98 pikë).
    - d) Programet studimore të cilat e kanë nivelin e parë dhe të dytë të integruar, nota mesatare e studimeve shumëzohet me katër (p.sh.: nota mesatare  $8.49 \times 4$  e barabartë me 33.96 pikë);
- II. Të gjitha ndryshimet e sipershënuara janë pjesë përbërëse të Rregullores nr. 1/775 të datës 9.9.2014.
- III. Ky vendim mbi ndryshimin e pikës 1, paragrafit 4 të nenit 7 të Rregullores bazike nr. 1/775 të datës 9.9.2014, hyn në fuqi nga dita e miratimit.





UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

u.d. Rektor  
Prof. Dr. Anton Berishaj

Nr. Prot.: 91775  
Datë: 9/9/2014

Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e datës 31.7.2014, mori këtë

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja për studimet e doktoratës në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.
- II. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Rektori.

A r s y e t i m

Duke pasur parasysh domosdoshmërinë për hartimin e një rregulloreje e cila përcaktohen kriteret e domosdoshme për organizimin e studimeve të doktoratës në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” sipas së cilës do të sqarohen dhe rregullohen në mënyrë të hollësishme kriteret, kushtet organizimi dhe realizimi i studimeve të doktoratës në Universitetin e Prishtinës, gjithnjë brenda kornizave të akteve ligjore dhe nënligjore, Senati i Universitetit të Prishtinës, me shumicë absolute të votave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Menaxhmentit të UP-së;
2. Dekanëve të njësive akademike të UP-së;
3. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
4. Zyrtarit ligjor të UP-së;
5. Arkivit të UP-së.





UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorx Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1775  
Datë: 9/9/2014

**RREGULLORE  
PËR STUDIMET E DOKTORATËS**

*Dispozitat e përgjithshme*

**Neni 1**

- (1) Me Rregulloren për studime të doktoratës në Universitetin e Prishtinës (në vazhdim: Rregullorja) rregullohet organizimi dhe realizimi i studimeve të doktoratës në Universitetin e Prishtinës (në vazhdim: Universiteti), institucioni përgjegjës për organizimin e studimeve (në vazhdim: institucioni përgjegjës i studimeve), format dhe kohëzgjatja e studimeve, kriteret për regjistrimin në studime, mënyra e realizimit të studimeve, mësimi dhe hulumtimi, procedura e paraqitjes, e vlerësimit dhe e mbrojtjes së punimit të doktoratës, të drejtat dhe obligimet e studentit në studime të doktoratës (në vazhdim: doktoranti), të drejtat dhe obligimet e mentorit, mënyrat e sigurimit të cilësisë, si dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me organizimin dhe realizimin e studimeve të doktoratës.
- (2) Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret e domosdoshme për aktivitetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

**Neni 2**

Kuptimi i nocioneve sipas kësaj Rregulloreje:

- (1) Këshilli i studimeve të doktoratës, në nivel të njësisë akademike (*fakultetit*), është këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike, ndërsa në nivel të Universitetit është Këshilli qendror i studimeve të doktoratës.

1. Këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike përbëhet nga 5 ose 7 anëtarë nga radhët e profesorëve nga secili departament i njësisë akademike. Mbledhja e parë (konstitutive) ftohet dhe udhëhiqet nga dekani i njësisë akademike. Pas konstituimit të këshillit të studimeve të doktoratës, ai nga radhët e veta e zgjedh kryetarin.
2. Këshilli qendror i studimeve të doktoratës ka këtë përbërje:
  - Rektori;
  - Prorektori për kërkime shkencore;
  - Prorektori për mësim;
  - Një përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave shoqërore;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave humanistike;

- Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave teknike;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i arteve;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave matematike-natyrore;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i mjekësisë;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave të bujqësisë dhe veterinës;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave juridike;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave ekonomike;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i edukimit fizik dhe sportit;
  - Drejtori i Zyrës për Zhvillim Akademik (ZZHA) – pa të drejtë vote.
3. Anëtarët e Këshillit qendror të studimeve të doktoratës i propozon rektori dhe i zgjedh Senati.
  4. Këshilli qendror i studimeve të doktoratës kryesohet nga rektori. Në mungesë të tij/saj, Këshilli kryesohet nga prorektori për kërkime shkencore. Në rastin e votave të barabarta, vota e kryesuesit është përcaktuese.
- (4) Institucioni përgjegjës i studimeve është një ose më shumë njësi akademike, një ose më shumë universitete brenda dhe jashtë vendit, të cilat i organizojnë dhe i realizojnë studimet e doktoratës, dhe të cilat e përfundojnë procedurën e arritjes së doktoratës shkencore/artistike.
- (5) Udhëheqësi i programit të studimeve të doktoratës është i punësuari me titull shkencor-mësimor, artistik-mësimor ose me titull shkencor në njësinë akademike në të cilën zhvillohen studimet.
- (6) Mentorë është personi i emëruar me titull shkencor-mësimor ose artistik-mësimor, i cili e udhëheq doktorantin gjatë punimit të disertacionit të doktoratës.
- (7) Dosja e doktorantit është dosja e cila i përmban të gjitha shënimet qenësore të doktorantit prej momentit të pranimit të tij e deri te promovimi. Njësia akademike përkatëse është përgjegjëse përmblledhjen dhe përruajtjen e të dhënave në dosje.

### Neni 3

- (1) Studime të doktoratës ofrojnë njësitë akademike (*fakultetet*) dhe/ose universiteti/universitetet në një a më shumë lëmenj shkencorë, nëse kanë kontratë të nënshkruar përmarrëdhënie pune me orar të plotë, me më së paku gjysmën e numrit të arsimtarëve të angazhuar në atë program studimi.
- (2) Studimet e doktoratës mund të themelohen dhe të realizohen vetëm në ata lëmenj shkencorë në të cilët institucioni përgjegjës ka arritje të pranuara ndërkombëtare në kërkimet shkencore ose artistike, përkatësisht në krijuimtarinë artistike, e që konfirmohet me akreditimin e tyre nga Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA).
- (3) Me studimet e doktoratës udhëheq këshilli i studimeve të doktoratës (në vazhdim: Këshilli i studimeve të doktoratës në njësinë përkatëse akademike).
- (4) Karakteristikat themelore të studimeve të doktoratës në Universitet janë hulumtimi dhe të mësuarit nëpërmjet hulumtimit, ndërkombëtarizimi, transparenca, vlerësimi ndërkombëtar i cilësisë dhe konkurenca ndërkombëtare.
- (5) Me qëllim të sigurimit të cilësisë dhe nxitjes së lëvizshmërisë/mobilitetit të doktorantëve dhe të stafit akademik, studimet e doktoratës janë të hapura për çdo formë të bashkëpunimit me institucionet e ngjashme brenda dhe jashtë vendit.

## *Qëllimet e studimeve të doktoratës*

### **Neni 4**

Qëllimet e studimeve të doktoratës janë:

1. Krijimi i diturive, i njojurive dhe i praktikave artistike të reja dhe relevante, si dhe zbatimi i tyre;
2. Arsimimi i hulumtuesve dhe i studiuesve të dalluar në fusha të caktuara shkencore ose artistike;
3. Aftësimi i doktorantëve për punë të pavarur kërkimore/artistike, për hulumtime të pavarura dhe për vlerësime kritike të punës së të tjera;
4. Arritja e diturive, përvojave dhe shkathtësive, të cilat duhet t'u mundësojnë doktorëve të shkencave që, në mënyrë kreative dhe të mbështetur në hulumtime, të ofrojnë kontribut origjinal dhe domethënës në fushat përkatëse të dijes;
5. Ndërkombëtarizimi i punës kërkimore/artistike në Universitet.

## *Mësimi dhe hulumtimi në studimet e doktoratës*

### **Neni 5**

- (1) Komponenti thelbësor i studimeve universitare të doktoratës është kërkimi dhe krijimi shkencor/artistik.
- (2) Format e punës në studimet e doktoratës janë seminaret kërkimore, puna eksperimentale, punëtoritë dhe grupet e diskutimit, me qëllim të zhvillimit të punës kërkimore, mendimit kritik, përvetësimit të metodologjisë dhe shkathtësive të përgjithshme.
- (3) Mësimi në formë të ligjëratave nuk mund të kalojë 20 përqindëshin e ngarkesës së përgjithshme të paraparë me programin e studimeve dhe të llogaritur sipas sistemit evropian të transferimit të krediteve (ECTS).
- (4) Sipas mundësive dhe në bazë të kushteve të përcaktuara paraprakisht, ndjekja e mësimeve në studimet e doktoratës është e hapur për të gjithë doktorantët e Universitetit. Disa pjesë të kërkimeve dhe të mësimit në studimet e doktoratës mund të ndiqen edhe nga doktorantët e universiteteve të tjera, sipas kushteve të parapara në kontratën paraprakisht të nënshkruar ndërmjet universiteteve në fjalë.
- (5) Me qëllim të arritjes së interdisiplinaritetit dhe në bazë të arsyetimit dhe pëlqimit të mentorit, si dhe të pëlqimit të këshillit të studimeve të doktoratës, doktorantët mund të kryejnë pjesë të caktuara të kërkimit dhe të krijimtarisë artistike edhe në njësitë e tjera akademike të Universitetit ose në institucione të tjera përkatëse brenda dhe jashtë vendit.
- (6) Këshilli i studimeve të doktoratës mund t'u caktojë doktorantëve lëndë plotësuese për arritjen e diturive themelore, të domosdoshme për vijimin dhe përfundimin e studimeve.

## *Format e studimeve të doktoratës*

### **Neni 6**

- (1) Studimet e doktoratës mund të organizohen në njëren prej këtyre formave:
  1. Studimet e doktoratës për të cilat institucion përgjegjës është vetëm një njësi akademike ose Universiteti;
  2. Doktorata e dyfishtë, në të cilin doktoranti i merr dy diploma dhe për të cilën është i obliguar edhe mentorimi i dyfishtë;

3. Studimet e përbashkëta të cilat i realizojnë dy ose më shumë universitete, por vetëm një universitet është institucion përgjegjës;
  4. Modeli në të cilin doktoranti i regjistron studimet në një universitet dhe merr diplomën e institucionit përgjegjës të studimeve, ndërsa kërkimet i kryen në më shumë institucione dhe mund të ketë më shumë mentorë;
  5. Studimet e përbashkëta janë program i akredituar i dy ose më shumë universitetave. Secili universitet merr pjesë në regjistrimin e doktorantëve, ndërsa doktoranti mund të fitojë diplomë të vetme të dy ose më shumë universitetave, ose diplomën e universitetit në të cilin i ka regjistruar studimet e doktoratës, e në të cilën shkruan se studimet kanë qenë të përbashkëta.
- (2) Nuk lejohet transferimi i studimeve të doktoratës nga një njësi akademike në tjetrën brenda Universitetit të Prishtinës, e as nga universitetet e tjera në Universitetin e Prishtinës. Studentët pranohen vetëm në bazë të konkurrimit në konkursin e shpallur.

### *Kushtet e regjistrimit dhe kohëzgjatja e studimeve*

#### **Neni 7**

- (1) Kushtet e regjistrimit i përcakton Senati i Universitetit, me propozimin e KQSD-së dhe në pajtim me këtë Rregullore.
- (2) Konkursi publik për regjistrim në studime të doktoratës shpallet më së paku një muaj para fillimit të vitit akademik. Të drejtë konkurrimi për regjistrim në studimet e doktoratës kanë:
  1. Të diplomuarit para hyrjes në fuqi të studimeve sipas Deklaratës së Bolonjës, të cilët duhet të jenë magjistra të shkencës përkatëse;
  2. Të diplomuarit pas hyrjes në fuqi të studimeve në bazë të deklaratës së Bolonjës – niveli i studimeve master shkencor;
  3. Të diplomuarit që kanë së paku 300 kredite European Credit Transfer System (ECTS);
  4. Kandidatët me notë mesatare jo më të ulët se 8.00 në secilin nivel të studimeve paraprake veç e veç;
  5. Kandidatët të cilët e kanë dëshminë për njohjen e një gjuhe të huaj botërore (anglisht, gjermanisht, frëngjisht ose gjuhë tjetër botërore) nga institucioni i autorizuar (fakulteti përkatës ose institucionet e akredituara).
- (3) Kriteret e vlerësimit të kandidatëve përfshijnë: suksesin në shkollim gjatë studimeve, interesin e treguar për kërkime shkencore/artistike, punimet e botuara, rekomandimet e dy profesorëve nga lëmi përkatës dhe propozimin e lëmit – fushës së hulumtimit. Intervista me kandidatin është obliguese, por nuk vlerësohet me pikë. Gjatë regjistrimit përcaktohen qartë të gjitha kushtet e domosdoshme përfundimin e studimeve në kohën e paraparë.
- (4) Kriteret e përcaktimit të përparësisë në radhitje përzgjedhëse janë:
  1. Nota mesatare gjatë studimeve themelore dhe Master ka një vlerë maksimale prej 40 pikëve (që shpërndahet përpjestimi: 20 pikë maksimale për notën mesatare në studime themelore dhe 20 pikë maksimale për notën mesatare në studime Master), të cilat pikë llogariten në mënyrën si në vijim:
    - a. Nota mesatare 8 – 8.50: 5 pikë
    - b. Nota mesatare 8:51 – 9.00: 10 pikë
    - c. Nota mesatare 9:01 – 9.50: 15 pikë
    - d. Nota mesatare 9.51 – 10.00: 20 pikë
  2. Magjistratura nga lëmi shkencor ose specializimi nga lëmi i ngushtë shkencor vlerësohet me 5 pikë;

3. Aktiviteti kërkimor – shkencor, siç dëshmohet me botimet dhe prezantimet si në vijim, vlerësohet me një vlerë maksimale deri në 35 pikë:
- Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit dhe të indeksuar në *Current Contents*: autori i parë/korrespondent 5 pikë, të tjerët 2 pikë.
  - Për çdo artikull të botuar në pesë vjetët e fundit në revista të tjera ndërkombëtare të indeksuara: autori i parë 3 pikë, të tjerët 1 pikë.
  - Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit në revista akademike vendëse, që botohen nga Universiteti i Prishtinës ose nga qendrat apo institutet e tij, nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, nga Instituti Albanologjik dhe nga Institut i Historisë, dhe që përdorin vlerësimin ose vlerësimin nga kolegët e fushës: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë.
  - Për libër universitar të botuar në pesë vjetët e fundit nga lëmi i ngushtë: autori ose bashkautori 5 pikë gjithsej.
  - Për çdo prezantim gojor të punimit në pesë vjetët e fundit në tubime (konferanca, kongrese, simpoziume) ndërkombëtare shkencore të indeksuara dhe të botuar në përbledhjen e punimeve: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë.
  - Për çdo prezantim në formë afisheje të punimit në pesë vjetët e fundit në tubime (konferanca, kongrese, simpoziume) ndërkombëtare shkencore të indeksuara dhe të botuar në përbledhjen e punimeve: autori i parë 1 pikë, të tjerët 0.5 pikë.
  - Për çdo prezantim gojor në pesë vjetët e fundit në tubime (konferanca, kongrese, simpoziume) shkencore me karakter vendës: autor i parë 1 pikë, të tjerët 0.5 pikë.
- Njohuria e gjuhës angleze ose gjuhës së huaj botërore, relevante për fushën e studimit, deri në 20 pikë maksimale.
  - Njësitë akademike mund të parashtronë për miratim nga Senati kriterë shtesë, varësisht nga programi i studimeve të doktoratës.
  - Në kushte të barabarta, përparësi i jepet kandidatit që është staf i rregullt i UP-së.
- (2) Njësitë akademike e propozojnë numrin e studentëve për regjistrim, ndërsa Senati, me propozimin e Këshillit qendror të studimeve të doktoratës e merr vendimin përfundimtar për numrin e studentëve, duke pasur parasysh kapacitetet hulumtuese, mësimore dhe mentoriale të njësisë akademike.
- (3) Senati i Universitetit, me propozimin e njësisë akademike dhe pas shqyrtimit në Këshillin qendror të studimeve të doktoratës, merr vendim përfundimtar për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës. Emrat e kandidatëve të pranuar, me të gjitha të dhënata kriterieve të përzgjedhjes, shpallen publikisht në uebfaqen e njësive akademike dhe në uebfaqen e Universitetit.
- (4) Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tre vjet, por, për shkaqe të arsyeshme, e për të cilat vendos Këshilli i studimeve të doktoratës, mund të vazhdojnë deri në pesë vjet. Për studentët që e kanë mbaruar magjistraturën shkencore dhe të cilët vazhdojnë studime të doktoratës në lëmin e njëjtë mund të transferojnë deri në 1/3 e numrit të përgjithshëm të kredive të parapara. Për transferimin e kredive vendos Këshilli i doktoratës i njësisë akademike, në bazë të kërkuesës së kandidatit. Pas kalimit të afatit prej pesë vjetësh nga dita e regjistrimit, doktoranti e humb të drejtën për mbrojtje të punimit të doktoratës, përvèç nëse Senati i UP-së, me propozim të KQSD-së dhe duke u bazuar në një arsyetim të dëshmuar të kandidatit, merr vendim tjetër.
- (5) Në rast se cilësia e punimit të doktoratës, e vlerësuar me raportet vjetore të progresit, të cilat i zbaton këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike, nuk i plotëson kriteret e parapara,

këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike mund t'i propozojë KQSD-së, e ky Senatit, të marrë vendim që doktorantit t'ia marrë të drejtën për t'i vazhduar studimet.

### *Fazat e studimeve të doktoratës*

#### **Neni 8**

Studimet e doktoratës organizohen në gjashtë semestra:

1. Në semestrin e parë studenti i akumulon 30 ECTS nga provimet e lëndëve profesionale nga fusha e ngushtë e drejtimit të cilin e ka regjistruar.
2. Në semestrin e dytë, studenti i akumulon 30 ECTS nga seminaret e gruplëndëve të parapara në programin studimor.
3. Në semestrin e tretë studenti i grumbullon 30 ECTS pas vlerësimit pozitiv dhe ratifikimit të projekt-propozimit të doktoratës nga ana e këshillit të doktoratës së njësisë akademike dhe Këshillit qendror për studime të doktoratës, si dhe aprovimit të mentorit nga Senati i Universitetit.
4. Në tre semestrat e mbetur, studenti akumulon 90 ECTS përmes:
  - Së paku një publikimi shkencor të një pjese të rezultateve të doktoratës në një revistë të indeksuar (shih revistar e caktuara nga njësitë akademike) me recension ndërkombëtar nga lëmi përkatës (20 ECTS);
  - Së paku dy prezantimeve në tubime shkencore (konferanca, kongrese, etj.), prej të cilave njëra me karakter ndërkombëtar (10 ECTS);
  - Përfundimit dhe mbrojtjes publike të punimit të doktoratës (60 ECTS).

#### *Mentorimi*

#### **Neni 9**

- (1) Të drejtë për të udhëhequr kandidat për doktoratë ka:
  1. Mësimdhënësi me titull akademik profesor i rregullt (prof. dr.) ose profesor i asocuar (prof. assoc.), që është në marrëdhëniet të rregullt pune në UP;
  2. Përjashtimisht, me kërkesë të Këshillit të Fakultetit, për mentor mund të angazhohet edhe mësimdhënësi me titull akademik profesor asistent (prof. ass.) nëse ka së paku tri (3) punime të botuara në revista me recension ndërkombëtar. Dëshmia për publikimin e punimeve duhet të sillet në Këshillin qendror të studimeve të doktoratës;
  3. Mentor, në rast të veçantë, mund të jetë edhe *profesor emeritus*, ndërsa vendimin për këtë e merr Senati, me propozim të këshillit të doktoratës të njësisë akademike në kuadër të së cilës organizohen studimet ose të këshillit të lëmit shkencor.
- (2) Mentor, pa përjashtim, duhet të jetë nga fusha e ngushtë shkencore nga e cila përgatitet doktorata.
- (3) Nëse ka bashkëmentor të jashtëm, ai/ajo duhet ta dorëzojë paraprakisht një CV dhe një letër pëlgimi në këshillin e doktoratës së njësisë akademike.
- (4) Një mentor mund ta marrë për udhëheqje më së shumti dy kandidatë të regjistruar brenda një viti akademik, por jo më shumë se pesë kandidatë njëkohësisht.
- (5) Para se ta marrë detyrën e mentorit për herë të parë, atëherë kur Universiteti e konsideron të nevojshme, secili mentor duhet ta kalojë punëtorinë e mentorimit, të cilën e organizon Universiteti.

- (6) Mësimdhënësi i një njësie akademike të Universitetit të Prishtinës (UP) mund të jetë mentor në ndonjë universitet tjeter, nëse ka miratim me shkrim nga njësia akademike.
- (7) Për mentor nuk mund të propozohet profesori i pensionuar.
- (8) Mentor i cili është emëruar në këtë funksion para se të pensionohet ka të drejtë ta kryejë mentorimin deri në fund.
- (9) Për të siguruar cilësi të punimit të doktoratës, në rast se është nevoja (p.sh. hulumtimi ndërdisiplinor, zhvillimi i kërkimit apo i krijimit artistik në disa institucione), këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike i propozon KQSD-së, e ky Senatit, për të marrë vendim për mentorim të dyfishtë.

### *Obligimet e mentorit*

#### **Neni 10**

- (1) Mentor i ka obligim ta udhëheqë doktorantin gjatë punës së punimit të doktoratës, ta përcjellë cilësinë e punës së doktorantit, ta përkrahë publikimin e punimeve të tij dhe pjesëmarrjen në projekte shkencore dhe artistike.
- (2) Në rast se janë disa mentorë, secili prej tyre i mban përgjegjësitë e veta për pjesën e hulumtimit, paraprakisht të përcaktuar dhe për procedurën e punës në punimin e doktoratës.
- (3) Mentor i ka obligim që një herë në vit t'i paraqesë raport për punën e doktorantit këshillit për studime të doktoratës të njësisë akademike, në formular të Universitetit.

### *Obligimet dhe të drejtat e doktorantit*

#### **Neni 11**

- (1) Doktoranti është i obliguar që një herë në vit, në formular të Universitetit, t'ia paraqesë këshillit të studimeve të doktoratës raportin për punën e tij (me mundësi të prezantimit të hulumtimit).
- (2) Doktoranti ka të drejtë që vetëm një herë gjatë studimeve ta ndërrojë mentorin ose temën, në bazë të kërkesës me shkrim, si dhe të deklaratës së mentorit të deriatëhershëm, në formular të Universitetit.
- (3) Doktoranti është i obliguar që, para mbrojtjes së punimit të doktoratës, të ketë të botuar së paku një publikim shkencor si autor i parë i një pjese të rezultateve të doktoratës në një revistë të indeksuar (shih revistar e caktuara nga njësítë akademike) me recension ndërkombëtar nga lëmi përkatës, të ketë së paku dy prezantime në tubime shkencore (konferanca, kongrese, etj.), prej të cilave njëra me karakter ndërkombëtar e në të cilin është autor i parë ose i dytë, me kusht që (a) autori i parë të jetë mentor i tij, dhe që ky prezantim të bëhet nga vetë kandidati, ose të ketë promovim publik të veprës artistike në hapësira publike. Çdo punim mund ta kualifikojë vetëm një doktorant.

### *Punimi i doktoratës*

#### **Neni 12**

- (1) Punimi i doktoratës është punim origjinal shkencor/artistik, i cili i nënshtronhet vlerësimit publik shkencor/artistik.
- (2) Përjashtim nga kjo procedurë janë punimet e veçanta të doktoratës, siç i parashikon nenii 18 i kësaj Rregulloreje.

## Neni 13

Format e punimit të doktoratës janë:

- (1) Monografia;
- (2) Punimi i doktoratës në lëmin artistik është hulumtim artistik original në kontekst të krijimtarisë bashkëkohore artistike dhe mbaron me prezantimin e veprës artistike dhe me një punim teorik adekuat.

## Neni 14

- (1) Punimi i doktoratës duhet të jetë i shkruar në gjuhën shqipe. Në raste të veçanta ai mund të shkruhet edhe në ndonjë gjuhë tjetër, por detyrimisht të dorëzohet i përkthyer edhe në gjuhën shqipe.
- (2) Titulli, rezymeja dhe fjalët kyçe të punimit të doktoratës, përvç në gjuhën burimore, duhet të jenë të shkruara patjetër edhe në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Rezymeja duhet të mundësojë të kuptuarit e qëllimit të punimit, metodave të hulumtimit, rezultateve dhe përfundimeve.
- (3) Pamja grafike e punimit të doktoratës përcaktohet nga Universiteti.

### *Procedura e paraqitjes, e vlerësimit dhe e pranimit të temës (projektit) së kërkimit të doktoratës*

## Neni 15

- (1) Gjatë vitit të parë të studimeve të doktoratës, doktoranti e propozon mentorin dhe temën, si dhe paramarrëveshjen e kushteve të punës dhe kushtet e financimit të hulumtimit.
- (2) Doktoranti e fillon procedurën e paraqitjes së projekt-propozimit të temës së doktoratës me dorëzimin e fletëparaqitjes, e cila i përmban shënimet personale të doktorantit, jetëshkrimin dhe titullin e temës së propozuar, të dhënat për mentorin e propozuar dhe kompetencat e tij, arsyetimin e temës dhe pritjet e kontributit shkencor original të hulumtimit të propozuar, vlerësimin e shpenzimeve të hulumtimit, si dhe deklaratën se nuk ka paraqitur punim doktoratë me të njëjtën temë në studime të tjera universitare, përkatesisht në ndonjë universitet tjetër. Tema e punimit të doktoratës paraqitet në formular të Universitetit.
- (3) Këshilli i njësisë akademike, me propozim të Këshillit të studimeve të doktoratës, e emëron komisionin për vlerësimin e temës dhe e miraton propozimin për mentorin në afat prej një muaji nga data e protokollimit të kërkesës së parashtruar. Ky komision përbëhet prej tre ose pesë anëtarëve, nga të cilët së paku një anëtar nuk duhet të jetë mësimdhënës i studimeve në fjalë e as i punësuar në njësinë akademike (fakultetin), e cila është përgjegjëse e studimeve. Mentor i propozuar nuk mund të emërohet për kryetar të komisionit.
- (4) Komisioni për vlerësimin e temës e jep vlerësimin për kontributin shkencor/artistik original dhe për zbatimin e kërkimit në pikëpamje financiare dhe organizative, më së largu një muaj pas paraqitjes së kërkesës.
- (5) Këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike duhet doemos ta shqyrtojë propozimin e komisionit për vlerësim të temës dhe propozim të mentorit në semestrin e tretë të studimeve të doktoratës.
- (6) Projekt-propozimi i punimit të doktoratës mbrohet para këshillit të studimeve të doktoratës të njësisë akademike, para komisionit për vlerësim dhe mentorit të propozuar, 30 ditë pas dorëzimit të raportit të komisionit për vlerësim.

- (7) Këshilli i njësisë akademike, me propozim të këshillit të studimeve të doktoratës, ia propozon temën dhe mentorin për miratim Senatit të Universitetit. Senati duhet ta aprovojë temën dhe mentorin më së largu një muaj nga pranimi i kërkesës nga njësia akademike.
- (8) Të gjitha hulumtimet shkencore në njerëz dhe me njerëz, ose me shtazë, doemos duhet të jenë në pajtim me dispozitat e Rregullores së këshillit etik, duhet ta kenë lejen e këshillit etik të fakultetit apo Universitetit, si dhe të institucionit në të cilin zbatohet hulumtimi; pëlqimin e të gjithë të hulumtuarve veç e veç (pacientëve, përkatësish vullnetarëve), nëse janë në gjendje të aftë ta bëjnë këtë, përkatësish të kujdestarëve të tyre ose të përfaqësuesit ligjor të tyre.

### *Procedura e vlerësimit të punimit të doktoratës*

#### **Neni 16**

- (1) Punimin e doktoratës, me pëlqimin dhe mendimin e mentorit të shkruar dhe të nënshkruar për hulumtimin e kryer dhe kontributin e arritur shkencor origjinal, doktoranti e dorëzon zyrtarisht në fakultet ose në Universitet (nëse studimet organizohen në nivel universiteti). Në rast se mentorri nuk dëshiron të japë pëlqimin, ka obligim që brenda 15 ditësh të japë me shkrim arsyetimin. Pas kësaj periudhe, në afat prej 15 ditësh pas dorëzimit të arsyetimit të mentorit, këshilli për studime të doktoratës i njësisë akademike e shqyrton arsyetimin e mentorit dhe i propozon këshillit të njësisë akademike formimin ose refuzimin e emërimit të komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës. Në të dyja rastet, arsyetimi i mentorit u jepet anëtarëve të komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës, të cilët do ta kenë parasysh gjatë vlerësimit.
- (2) Para se të dorëzohet punimi në procedurë për vlerësim, shërbimi i studimeve të doktoratës i njësisë akademike duhet ta vërtetojë me shkrim se doktoranti i ka kryer të gjitha obligimet, ashtu siç është paraparë me programin e studimeve të doktoratës.
- (3) Për vlerësimin e punimit doktoranti e paraqet punimin në formë të shkruar në letër dhe në formë elektronike. Te veprat artistike të doktorantit, pos prezantimit publik, doktoranti e dorëzon edhe pjesën teorike dhe dokumentacionin përkatës për vlerësimin e punimit.
- (4) Këshilli i njësisë akademike, me propozim të këshillit të studimeve të doktoratës, e emëron komisionin për vlerësimin e punimit të doktoratës. Komisioni i ka tre ose pesë anëtarë, me përfshirje të së paku një anëtar nga ndonjë universitet jashtë Kosovës. Mentorri nuk mund të jetë anëtar i komisionit për vlerësimin e punimit.
- (5) Anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës patjetër duhet të kenë së paku titullin akademik profesor asistent (prof. ass.).
- (6) Njëherazi me emërimin e komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës, Universiteti e shpall titullin dhe rezymenë e punimit në gjuhën shqipe dhe angleze në faqet e internetit të Universitetit dhe në këtë mënyrë mundëson që punimi t'i nënshtronhet kritikës shkencore dhe profesionale.
- (7) Anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës dhe të gjithë ata të cilëve u është mundësuar shqyrtimi i punimit të doktoratës janë të obliguar që, para se të paraqitet publikisht vlerësimi, të kenë kujdes me të dhënat dhe të arriturat në punimin në fjalë, me qëllim të ruajtjes të kontributit shkencor të punimit të doktoratës si pronë intelektuale.
- (8) Komisioni për vlerësimin e punimit të doktoratës është i obliguar që brenda një muaji nga emërimi ta përpilojë raportin e shkruar për vlerësimin e punimit të doktoratës. Kryetari i komisionit e përgatit raportin, duke i pasur parasysh mendimet me shkrim të anëtarëve të komisionit, ndërkaq raportin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e komisionit. Çdo anëtar i komisionit ka të drejtë të japë vlerësim të veçantë.
- (9) Komisioni për vlerësimin e punimit të doktoratës propozon:

1. pranimin e punimit të doktoratës me deklaratë eksplikite për kontributin origjinal shkencor/artistik, ose
2. plotësimin e punimit të doktoratës dhe vlerësimin përfundimtar, ose
3. refuzimin e punimit të doktoratës, pas së cilës doktoranti e humb të drejtën e arritjes së gradës doktor shkencor/artistike me atë studim.

Arsyetimi është pjesë e domosdoshme e raportit. Në seancën e parë të radhës, këshilli i njësisë akademike, me propozimin e komisionit të studimeve të doktoratës, i propozon Senatit emërimin e komisionit për mbrojtje publike të punimit të doktoratës.

### *Procedura e mbrojtjes të punimit të doktoratës*

#### Neni 17

- (1) Doktoranti mund t'i nënshtrohet mbrojtjes së punimit të doktoratës, pasi Këshilli i njësisë akademike ta ketë miratuar vlerësimin pozitiv të komisionit për vlerësimin e punimit/dorëshkrimit të doktoratës, i cili duhet të ratifikohet nga Senati brenda një afati prej dy muajsh nga data e dorëzimit në KQSD.
- (2) Doktoranti, në marrëveshje me dekanin e njësisë akademike dhe me komisionin për mbrojtje të punimit të doktoratës, detyrimisht duhet ta bëjë mbrojtjen publike të punimit të doktoratës brenda afatit prej një (1) muaji nga dita e ratifikimit në Senat.
- (3) Komisioni për mbrojtje të punimit të doktoratës përbëhet nga tre apo pesë anëtarë. Komisioni për mbrojtje të punimit të doktoratës mund të jetë në përbërje të njëjtë si komisioni për vlerësimin e punimit të doktoratës, përvèç mentorit. Mentor i merr pjesë në mbrojtje të punimit të doktoratës në anën e doktorantit, mirëpo nuk ka të drejtë në vendimmarrje.
- (4) Mbrojtja e punimit të doktoratës është publike. Thirrja për mbrojtje publike duhet të shpallet në hapësirat e njësisë akademike, në faqen zyrtare të internetit të njësisë akademike dhe të Universitetit, së paku tetë ditë para mbrojtjes. Mbrojtja duhet të organizohet në hapësirën e Universitetit, gjegjësisht të njësive të saj, në gjuhën në të cilën është shkruar punimi i doktoratës. Në rast të doktoratave të përbashkëta, mbrojtja mund të organizohet në universitet tjetër. Procedura e mbrojtjes rregullohet me protokoll.
- (5) Komisioni për mbrojtje të punimit të doktoratës e bën vlerësimin menjëherë pas mbrojtjes publike të punimit të doktoratës. Vlerësimi i mbrojtjes së punimit të doktoratës mund të jetë:  
- *e mbrojti me sukses të shkëlqyeshëm, shumë mirë, mirë (me vlerësim pikësh 100 - 80 të mundshme = "shumë mirë"; 79 – 65 pikë të mundshme = "mirë"; 64 – 50 të mundshme = "mjaftueshëm"; 49 e më pak pikë të mundshme = "pakalueshëm")*, ose *nuk e mbrojti*. Vendimi merret me shumicë votash të anëtarëve të komisionit për mbrojtje të punimit të doktoratës, të konstatuara me nënshkrimin e tyre. Disertacioni, i cili nuk e ka kaluar mbrojtjen, mund të ripunohet dhe të paraqitet për mbrojtje për herë të dytë, pas një periudhe prej 1 deri 2 vjetësh, pas së cilës humbet e drejta përimbrotje.
- (6) Për procedurën e mbrojtjes përpilohet procesverbali në gjuhën shqipe, e në rast se mbrojtja bëhet në gjuhë tjetër, procesverbali përpilohet edhe në atë gjuhë.

#### Neni 18

- (1) Në rast se rezultatet e hulumtimit të punimit të doktoratës përbëjnë gjëra të reja të mundshme për mbrojtje me të drejtat e pasurisë intelektuale, doktoranti dhe mentor i përkëtë e informojnë Shërbimin për transferim teknologjik të Universitetit ose të Komisionit qendror të studimeve të doktoratës. Në këtë rast, doktoranti, me pëlgim të mentorit, para se ta dorëzojë punimin e

- doktoratës për vlerësim, mund të bëjë kërkesë që me doktoratën e dorëzuar të veprohet në mënyrë diskrete, deri në momentin e mbrojtjes publike.
- (2) Shërbimi për transferim teknologjik ose Komisioni qendror i studimeve të doktoratës e zbaton procedurën për mbrojtje juridike dhe komerciale të rezultateve të hulumtimit, në pajtueshmëri me Rregulloren mbi shërbimin për transferim teknologjik. Në këtë rast, mbrojtja publike mund të shtyhet, në pajtim me doktorantin, më së largu për një vit, duke e llogaritur ditën e fillimit të procedurës së vlerësimit të punimit të doktoratës. Kërkesës për shtyrje të mbrojtjes publike duhet t'i bashkëngjitet vërtetimi i Shërbimit për transferim teknologjik.
  - (3) Procedura e gjithmbarshme e vlerësimit dhe e mbrojtjes, në rast se veprohet sipas alineve 1 dhe 2 të këtij neni, përcaktohet me akt të posaçëm të Universitetit.

### *Publikimi dhe ruajtja e punimit të doktoratës*

#### **Neni 19**

- (1) Punimi i doktoratës në tërësi shpallet në faqet e internetit të Universitetit, më së largu një muaj pas mbrojtjes. Informacioni për pjesën praktike të punimit të doktoratës nga lëmi artistik shpallet në faqe të internetit të Universitetit më së largu një muaj pas mbrojtjes. Në raste të jashtëzakonshme, për çka shërbimi i studimeve të doktoratës paraprakisht e bën arsyetimin, shpallja në faqe të internetit mund të shtyhet deri në dy vjet.
- (2) Punimi i doktoratës në formë të shtypur ruhet në tri (3) kopje në arkivin e njësisë akademike, tri (3) kopje në arkivin e Universitetit dhe tri (3) kopje në Bibliotekën Qendrore Universitare.
- (3) Punimi i doktoratës nga lëmi artistik ruhet, në përputhje me llojin e veprës, në formë adekuate (në formë të shkruar, në formë fotografie, videoregjistrimi, audioregjistrimi etj.) në arkivin e njësisë akademike, në arkivin e Universitetit, në Bibliotekën Qendrore Universitare, më së largu një muaj pas mbrojtjes.

### *Promovimi*

#### **Neni 20**

- (1) Doktoranti e fiton të drejtën e doktorit të shkencës/artit të paraparë me të drejtën e punës nga dita e mbrojtjes së suksesshme të punimit të doktoratës, ndërsa të drejtat e plota të gradës akademike dhe të diplomës me rastin e promovimit, kur edhe e bën betimin dhe nënshkruhet në Librin e doktoratës shkencore/artistike të Universitetit.
- (2) Doktoranti duhet që, brenda një muaji pas mbrojtjes, ta plotësojë formularin për promovim në gradë doktor shkencë/arti dhe ta dorëzojë në shërbimin e studimeve të doktoratës të njësisë akademike punimin e doktoratës të lidhur dhe në versionin elektronik për shpallje në faqet e internetit të Universitetit, gjegjësisht në formë të dokumentacionit të përshtatshëm të punimit të doktoratës në lëmin artistik (forma e shkruar, fotografi, videoregjistrim, audioregjistrim etj.).
- (3) Rektori ia dorëzon doktorantit diplomën e doktoratës në promovimin solemn, në të cilin doktoranti duhet të marrë pjesë personalisht ose, në rast të pamundësisë së pjesëmarrjes, ta autorizojë me shkrim një person tjetër që ta marrë diplomën për të.

### *Mënyra e sigurimit të cilësisë së studimeve të doktoratës*

#### **Neni 21**

- (1) Shërbimi i studimeve të doktoratës i njësisë akademike është i obliguar që të kujdeset për mbajtje dhe ruajtje të shënimave të hollësishme lidhur me punimin hulumtues dhe për kryerjen e

- detyrave të tjera studimore të çdo doktoranti, duke nënkuptuar këtu planin e obligimeve (përgatitja e dosjes së doktorantit), mbajtjen e shënimive për numrin e doktorantëve të regjistruar dhe numrin e doktorantëve të cilët e kanë mbrojtur punimin e doktoratës.
- (2) Këshilli i studimeve të doktoratës për çdo vit e bën vetëvlerësimin në bazë të raporteve vjetore të mentorëve dhe të doktorantëve, e për këtë e njofton këshillin e fakultetit, ndërsa ky i fundit Këshillin qendror të studimeve të doktoratës dhe Senatin e Universitetit.
  - (3) Raporti vjetor mbi vetëvlerësim i bashkëngjitet kërkesës përi akreditim.
  - (4) Kriteret për vlerësim përfshijnë: produktin shkencor/artistik të mësimdhënësve dhe të doktorantëve, mësimdhënien, cilësinë e punimeve të doktoratës, treguesit statistikorë të kohëzgjatjes së studimeve, treguesit statistikorë të numrit vjetor të doktorëve të rindër në krahësim me numrin e doktorantëve, si dhe realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

### *Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare*

#### **Neni 22**

- (1) Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Senati i UP-së.
- (2) Njësitë akademike obligohen që ta hartojnë udhëzuesin sipas kësaj Rregulloreje.
- (3) Formularët në vijim janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje, me të cilën rregullohet edhe përdorimi i tyre:
  - F1 – Paraqitja e temës së doktoratës;
  - F2 – Vlerësimi i temës së doktoratës;
  - F3 – Vendimi për aprovin e temës së punimit të doktoratës;
  - F4 – Raporti vjetor i doktorantit;
  - F5 – Raporti vjetor i mentorit për përparimin e doktorantit;
  - F6 – Kërkesa për ndërrim të temës dhe/ose të mentorit;
  - F7 – Kërkesë për shtyrje të mbrojtjes publike të punimit të doktoratës;
  - F8 – Udhëzimet përpilimin e punimit të doktoratës;
  - F9 – Raporti vjetor mbi veprimtarinë e studimit;
  - F10 – Raporti mbi vlerësimin e punës së doktoratës;
  - F11 – Protokolli dhe procesverbal i përmes mbrojtjen e punimit të doktoratës.
- (4) Për studime të doktoratës, të cilat kanë filluar para se të hyjë në fuqi kjo rregullore, zbatohen rregullat që kanë qenë në fuqi, dhe më së voni derisa të mos kalojë afati i përfundimit të studimeve të doktoratës me rregulloren e vjetër.
- (5) Dispozitat e kësaj Rregulloreje në tërësi zbatohen për studimet e doktoratës për të cilat procedura e akreditimit fillon pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.



Prof. dr. Anton Berishaj

Ud. i rektorit të UP-së